


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika c) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **12.11.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-4818/11, për ztr. *Njazi Thaqi* – Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Koorporatën Energjetike të Kosovës (KEK), për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4818-11, për Zyrtarin e lartë, ztr. *Njazi Thaqi* – Drejtor operacional në Koorporatën Energjetike të Kosovës (KEK), është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në një biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit, konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, ztr.Thaqi, është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas kësaj bisede, zyrtari i lartë, ztr. Njazi Thaqi, ka deklaruar se, menjëherë ka filluar procedurat për parandalimin e konfliktit të mundshëm të interesit.

Për ndryshimet e bëra në këtë biznes, ztr. Thaqi, me datën 05.11.2012, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellur një shkresë zyrtare dhe dokumentin zyrtar nga ARBK-ja (DPK.DPKI-03-3979/12), me informacionet e reja mbi biznesin; N.T.H. "Ice Espresso bar", në të cilat shihet se ai, tashmë, në mënyrë vullnetare, e ka shuar në tërësi këtë biznes.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

